

SHTETI LIGJOR NË SHQIPËRI: MIDIS ASPIRATËS DHE REALITETIT

Dr. Gentian ZYBERI*

Abstrakt:

Shqipëria hyri në rrugën e ndërtimit të demokracisë pas ndryshimeve të dhjetorit të vitit 1990. Duket qartë se, edhe pas tetëmbëdhjetë vjetësh tranzicion progresi i bërë në lidhje me konsolidimin e shtetit ligjor dhe sundimin e ligjit akoma mbeten në një nivel të pakënaqshëm.¹ Ndërmjet të tjerash, dy faktorët që kanë influencuar fuqishëm janë klima e ndezur politike që përgjithësisht ka zotëruar skenën politike shqiptare që nga vitet '90të dhe fryma e trashëguar klienteliste. Fatkeqësisht, influenca negative e këtyre dy faktorëve në ndërtimin dhe forcimin e institucioneve të pavarura dhe mirëfunksionuese në shërbim të qytetarit dhe zhvillimit të vazhdueshëm ekonomik e social vazhdon të ndihet edhe sot.

Në këtë punim autori nuk merr përsipër të bëjë një analizë të hollësishme të gjithë faktorëve që kanë influencuar procesin, por duket qartë që Shqipëria ka çaluar në ndërmarrjen e reformave të domosdoshme dhe në ngritjen e forcimin e shtetit ligjor. Krahas lirisë, të drejtave të njeriut, tregut të lirë, dhe demokracisë, sundimi i ligjit është një nga idealet të cilat shtetet sociale përpiqen t'i mbrojnë dhe konsolidojnë. Ky punim do të japë një pasqyrë të përgjithshme të shtetit ligjor dhe se çfarë ai nënkupton. Më pas theksi do të kalojë në kontekstin shqiptar. Çështja e forcimit të shtetit ligjor do të shihet dhe trajtohet si e lidhur ngushtë me reformën në drejtësi. Në këtë drejtim, domosdoshmëria e mirëfunksionimit të pushtetit gjyqësor, si një nga shtyllat kryesore të shtetit ligjor, dhe shkalla e reformës në këtë drejtim do të zënë një vend të konsiderueshëm. Në fund të punimit do të ofrohen disa konkluzione.

Fjalët çelës: *Shteti ligjor, aksesit në drejtësi, pushteti gjyqësor, reforma në drejtësi në Shqipëri.*

* Dr. Gentian Zyberi (LL.M), Lektor në të Drejtë Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Instituti Hollandez i të Drejtave të Njeriut (SIM), Universiteti i Utrecht-it, Hollandë.

¹ Për këtë shih raportet kritike të Komisionit Europian lidhur me vlerësimin e Shqipërisë në lidhje me këtë pikë si dhe vlerësimin negativ të Shqipërisë në lidhje me nivelin e korrupsionit dhe probleme të tjera nga disa organizma ndërkombëtarë.